

VENDIM
Nr. 280, datë 13.4.2016

**PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË PËRZGJEDHJES SË
PROJEKTEVE NË TURIZËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarëve, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për turizmin, në Komisionin e Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, si më poshtë vijon:

- z. Frederik Seiti, Sekretar i Përgjithshëm, Kryetar;

- znj. Sonia Popa, drejtor i Përgjithshëm
i Zhvillimit të Turizmit, anëtar;

- znj. Suzana Stefa, drejtor i Financës, anëtar;

- z. Ardit Çollaku, drejtor i Përgjithshëm
i Agjencisë Kombëtare të Turizmit, anëtar;

- z. Ergys Qirici, drejtor i Përgjithshëm i
Shërbimeve Mbështetëse, anëtar.

2. Caktimin e anëtarëve, përfaqësues të shoqatave në sektorin e turizmit, në Komisionin e Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, si më poshtë vijon:

- znj. Matilda Naço, Shoqata Shqiptare e
Turizmit (ATA), anëtar;

- z. Rudenc Ruka, Shoqata Kombëtare e
Guidave Turistike (NATGA), anëtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi